

# Ditari Natyres

“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A  
“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”  
Nr. 20 Viti i dytë i botimit Dhjetor 2014

## Në këtë numër do të gjeni:

- Takimi i katërt i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
- Festohet Dita e Verës në Parkun Kombëtar të Prespës
- Qyteti i Flamurit i bashkohet nismës Shqipëria JO Duhanit
- Mbillen mbi 100 fidanë në PNR Ulëz
- Seminar mbi burimet ujore të rajonit
- Workshop me fermerët që do të zbatojnë praktikatat e kompostimit
- Njoftime

# 10 VJET



*Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri i uron  
Gëzuar Festat e fund vitit të  
gjithë lexuesve dhe nëpërmjet  
tyre të gjithë miqve, kolegëve  
dhe bashkëpunëtorëve, duke i  
falenderuar për mbështetjen e  
v a z h d u e s h m e d h e  
bashkëpunimin e frytshëm në  
fushën e ruajtjes së natyrës dhe  
mjedisit në vendin tonë. Ne  
kemi bindjen që Viti i Ri 2015  
do të sjellë më shumë  
bashkëpunime, angazhime e  
përpjekje në realizimin e  
qëllimit tonë të përbashkët,  
ruajtjen e natyrës shqiptare  
dhe krijimi i një mjedisi sa më  
të qëndrueshëm për sot dhe brezat që do të vijnë.*



## Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE ÇALUP  
Bashkëjetja me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT  
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore  
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



SWEDEN

## *Takimi i katërt i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës*

**Korçë, 4 Dhjetor 2014** - U mbajt në Korçë takimi i katërt i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të organizatave partnere të rrjetit (INCA, Iliria-Tiranë, Miqësia-Ulëz, Adreatik-Vlorë, Clean&Green-Korçë, Çajupi-Gjirokastrë) si dhe përfaqësuesit të REC. Ky takim kishte si qëllim kryesor diskutimin e aktiviteteve në rrjet dhe veçanërisht planin për 2015.

Më që në se mbledhja e katërt e Rrjetit ishte e d h e mbledhja e fundit e parashikuar për këtë vit, takim u konsiderua i rëndësishëm sepse në të u bë një përmbledhje e të gjithë zhvillimeve më të



rëndësishmë në rrjet gjatë këtij viti nga përfaqësuesit e secilës organizatë, duke marrë në konsideratë aktivitetet individuale të tyre por edhe ato të përbashkëta të zhvilluara.

Gjatë takimit u theksuan arritjet e organizatave individuale dhe forcimi i rolit të tyre në nivel lokal por edhe pikat e dobta dhe mangësitë. Gjithashtu u diskutua linja e përgjithshme e zhvillimeve të fundit dhe njëkohësisht problemet teknike lidhur me afatet e raportimit për këtë vit. Duke përmbushur edhe objektivin kryesor të këtij takimi, sëbashku me përfaqësuesin e REC u diskutuan çështjet prioritare dhe objektivat për vitin 2015.

## *Festohet Dita e Verës në Parkun Kombëtar të Prespës*

**Goricë e Vogël, Prespë, 5 Dhjetor 2014** - Në kuadër të promovimit të Zonave të Mbrojtura dhe vlerave të tyre turistike të lidhura me natyrën dhe produktet lokale, Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës dhe organizata lokale Green&Clean, pjesë të këtij rrjeti, në bashkëpunim me institucionet lokale, organizuan më 5 Dhjetor, në fashtin Goricë të Vogël Festën e Verës.

Festimi i këtij rituali lokal tashmë është shndërruar në një festim tradicional në zonën e



Prespës, e cila është realizuar dy vitet e fundit me mbeshtjen e programi SENiOR-A, financiar nga qeveria Suedeze dhe mbështetur nga REC. Kjo festë realizohet për të promovuar

nëpërmjet shoqërisë civile dhe sjellë në vëmendjen e turistëve, por edhe autoriteteve, vlerat kulturore dhe mbi të gjitha natyrore që ofron kjo zonë për turizmin. Të pranishëm ishin Kryetari i Komunës, Prefekti i

*Vijon në faqe 3*

Vijon nga faqe 2 Qarkut Korçë, përfaqësues të REC Albania, përfaqësues të shoqërisë civile, administrata e parkut të Prespës, banorë e fermerë të zonës dhe nxënës të shkollave etj.

Festa nisi me grupet artistike dhe një ekspozitën e pikturave “Prespa ime” të realizuar me

punime të nxënësve të shkollave në ambintet e jashtme të godinës së Parkut Kombëtar Prespë. Pika me e



rëndësishme e këtij aktiviteti ishte konkursi i verës dhe painri me prodhimet e zonës. Vera e re e prodhuar nga prodhuesit e zonës dhe zona ve përreth, u nxorr nga fuçitë dhe u vlerësua nga një juri prej 7 vetash (me antarë nga shoqëria civile, pushteti vendor, përfaqësues të komunitetit dhe administratës së parkut). Në fund përfituesit e tre vendeve të para ndanë edhe çmime simbolike.

## *Qyteti i Flamurit i bashkohet nismës Shqipëria JO Duhanit*

Vlorë 13 Dhjetor 2014 - Qindra qytetarë vlonjatë janë bërë pjese e marshimit përgjate bulevardit kryesor të qytetit për ti thënë **JO Duhanit**.



U organizua në Vlorë takimi i katërt “Shqipëria Jo Duhanit!” – pas atij të Tiranës, Korçës dhe Beratit, ku ishte i pranishëm Ministri i Shëndetësisë Z. Ilir Beqaj, Kryebashkiaku i Vlorës Z. Shpëtim Gjika, drejtues të sistemit të kujdesit shëndetësor në vend, përfaqësues të shoqatave dhe aktorëve të shoqërisë civile, qytetarë dhe aktivistë të qytetit të Vlorës. Gjithashtu këtë

nismë e mbështetën edhe ekipet e futbollit të Flamurtarit dhe Partizanit.

Aktivitetet në kuadër të nismës [#ShqipëriaJoDuhanit](#) u organizuan nga një grup nismëtarësh të shoqërisë civile me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat synojnë rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të opinioit publik për zbatimin e ndryshimeve që kanë hyrë rishtazi në fuqi në Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit.



## *Mbillen mbi 100 fidanë në PNR Ulëz*

**Ulëz 23 Dhjetor 2014** - Në kuadër të muajit të pyllëzimeve Organizata “Miqësia” Ulëz, tërësisht me kontributin e saj, siguroi mbi 100 fidanë të llojit Pishë e butë dhe realizoi mbjelljen e tyre në ambientet e ndryshme të Parkut Natyror Rajonal të Ulzës.

Në mbjelljen e fidanëve kontribuan aktorë të ndryshëm dhe gjejmë rastin për të falenderuar

dhe përshëndetur për kontributin e tyre nxënësit e gjimnazit Qemal Stafa Tiranë, punonjësit e HEC-it, të Kishës dhe të gjithë aktorëve të tjerë të komunitetit të Ulëz për kontributin dhe angazhimin e tyre në këtë eveniment, njëkohësisht shpresojmë të mbetet traditë e viteve në vijim jo vetëm në Ulëz por në të Shqipërinë.



## *Seminar mbi burimet ujore të rajonit*

**Shkodër, 26 Dhjetor 2014** - Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës, anëtar i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, në kuadër të programit SENIORA, zhvilloi në Shkodër seminarin me temë: Burimet Ujore të Rajonit - Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Interpretimi i Roleve dhe Përgjegjësi institucionale në Nivel Vendor! Në seminar morën pjesë grupet e interesit, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile etj.



## Workshop me fermerët që do të zbatojnë praktikën e kompostimit

**Dajç, 5 Dhjetor 2014** - Në kuadër të projektit “Praktika të kompostimit”, i cili zbatohet nga Milieukontakt Shqipëri në bashkëpunimin me Komunën e Dajçit, u zhvillua një workshop me fermerë të komunës Dajç të cilët do të punojnë në zbatimin e praktikave. Takimi u zhvillua në mjediset e qendrës komunitare të Shirqit dhe synoi njohjen e fermerëve me aktivitetet e projektit, angazhimin e tyre si dhe me idenë e zgjerimit të kësaj iniciative në nivel fshati apo dhe komune në të ardhmen. Përveç të dhënave individuale mbi



sasinë e llojin e mbetjeve që grumbullojnë, sasinë e kompostos që prodhojnë apo blejnë, fermerët së bashku me ekspertët diskutuan mbi mënyrat dhe praktikën pozitive për tu përqafuar e bërë pjesë e projektit. Pjesë e aktiviteteve për procesin e kompostimit do të jenë dhe trainimet e këshillimet për të ngritur aftësitë e njohuritë e fermerëve me praktika të njohura dhe eficiente. Fermerët u shprehën mjaft pozitive në lidhje me

iniciativën e ndërmarr dhe njëkohësisht për përfshirjen e tyre, familjeve dhe pse jo përfshirjen e fqinjëve përgjatë procesit të kompostimit. Në workshop ishin të pranishëm stafi i komunës, të rinj, studentë dhe administratori i firmës së pastrimit për të mbështetur procesin por edhe për të

bashkënduar detyrat në lidhje me ofrimin e një shërbimi cilësor në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Sa më shumë fermerë ti bashkohen kësaj nisme apo ofrojnë mbetjet e tyre organike për të arritur një miksim, aq më cilësor do të jetë plehu, i pasur me Mikroelementë

dhe përbërës të tjerë të rëndësishëm për pasurimin e tokës dhe rritje të shëndetshme të produkteve bujqësore. Por gjithashtu kjo do të sjellë reduktimin e sasisë së mbetjeve që komuna gjeneron, grumbullon dhe i largon për në landfillin e Bushatit.

Nga

Milieukontakt Shqipëri

### NJOFTIME

- 1- The **Regional Activity Centre for Specially Protected Areas (RAC/SPA)** and the **Italian Society of Marine Biology (SIBM)**, partners of the organization of MSW '15, will offer several grants in order to facilitate participation to the MSW '15 to be held in Oristano in May from 18th to 22nd 2015. For details visit <http://mediterranean.seagrassonline.org/sardinia/>

### Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikujt, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës  
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437  
[www.inca-al.org](http://www.inca-al.org); [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org); [www.facebook.com/inca.albania](https://www.facebook.com/inca.albania)